



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT**  
**KORÇË**

**VENDIM**

**Nr. 28 Datë 25.02**

**PËR**

**PER MIRATIMIN E FONDIT PREJ 366 000 LEKE PER SHFAQJEN**  
**E DRAMES "PAMJE NGA URA" NGA TRUPA E TEATRIT**  
**KOMBETAR.**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët për miratimin e fondit prej 366 000 leke për venien në skenë të drames "Pamje nga ura" nga trupa e Teatrit Kombëtar, bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", nën 32 pikë "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjin nr 9836 dt. 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008", Udhëzimin nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008", Udhëzimin nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008", si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fondit total prej 366 000 lekë për shfaqjen e drames "Pamje nga ura" e teatrit Kombëtar i detajuar si më poshtë:

Pagese për dietat e trupës së aktoreve dhe teknikës:

34 persona x 2 000 leke x 3 ditë = 204 000 leke

Pagese transporti për trupën dhe transportin e dekorit të shfaqjes:

60 000 leke

Shpenzime për hotelieri:

34 persona x 1 000 leke x 3 nete = 102 000 leke

1 (1+2+3) = 366 000 leke

Ky fond do te perballohet nga fondi i planifikuar per depozitimin e kapitalit  
millesar per UIK-un, me kete strukture buxhetore:

|           |    |       |    |     |         |           |
|-----------|----|-------|----|-----|---------|-----------|
| Pakesohet | 00 | 01110 | 05 | Art | 6040000 | - 366 000 |
| Shtohet   | 00 | 08250 | 05 | Art | 6020000 | +366 000  |

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Politikave te Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatoret dhe Teatri "A.Z. Cajupi".

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare e Këshillit**

*Raimondo Nuse*  
**Raimonda NASE**